



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIK OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 46/2014
Datë: 25 shkurt 2014

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.14 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 25 shkurt 2014 mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Anketa e Prokurorëve të Kosovës për vitin 2013, lidhur me njohuritë e prokurorëve dhe të kuptuarit e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), duke u fokusuar në këto kategori të informatave:
 - a) Përvojën e prokurorëve, arsimimin dhe trajnimin;
 - b) Matjen e njohurive për ndryshimet procedurale në KPPK;
 - c) Të kuptuarit për konceptet themelore në kodin e ri; dhe
 - d) Sugjerime të hapura për problemet e hasura nga prokurorët dhe nevojat për trajnimin e tyre.
- II. Këshilli po ashtu miratoi rekomandimet e propozuara nga Anketa e Prokurorëve të Kosovës për vitin 2013.
- III. Këshilli me qëllim të adresimit të rekomandimeve nga pika II e këtij vendimi, autorizon z. Jusuf Mejzini, prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe z. Aleksander Lumezi, kryeprokuror në Prokurorinë e Apelit për hartimin e udhëzimit dhe trajnimin e prokuroreve lidhur me të gjeturat në Anketë me qëllim të harmonizimit të njohurive dhe shkathësive të prokuroreve në zbatimin e KPPK dhe unifikimin e praktikave në mes prokuroreve dhe Prokurorive.
- IV. Obligohen z. Mejzini dhe z. Lumezi që gjatë muajit mars dhe prill të vitit 2014 të organizojë trajnime për të gjithë prokuroret e PTH, PA dhe PSRK.
- V. Obligohet Sekretariati për publikimin e këtij Vendimi në ueb faqen e KPK-së.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ismet Kabashi
Kryetar i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorit të Apelit; PSRK, Kryeprokurorëve të PTH;
- z. Jusuf Mejzini dhe z. Aleksander Lumezi;
- Sekretariatit të ZKPSH dhe NJSHP
- Arkivit të PSH-së.

